



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

NR. 8 DATË 04.07.2013

**PËR MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE RINAS, SHPELLËZ, GURAKUQ, ORENJË E VOGËL,
ORENJË, QAFJA, SHMILL, KUTERMAN DHE ZDRAJSH, NË KOMUNËN ORENJË,
QARKU ELBASAN, PËR SHOQËRINË “ORENJA POWER” sh.p.k**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 70/8 dhe nenit 70/11 të Ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 502, datë 13.07.2011, “Për miratimin e rregullosës uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 87 datë 07.02.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, Këshilli Kombëtar i Territorit

V E N D O S I :

1. Miratimin e lejes zhvillimore komplekse për ndërtimin e hidrocentraleve Rinas, Shpellëz, Gurakuq, Orenjë e Vogël, Orenjë, Qafa, Shmill, Kuterman dhe Zdrajsh, në komunën Orenjë në qarkun Elbasan, për shoqërinë “Orenja Power” sh.p.k
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

SALI BERISHA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

SOKOL OLLDASHI

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT



SEKRETARE E KKT

KREUZA LEKA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

